



Nr. 24 Prot.  
Tiranë, më 12, 04 2023

Nr. 163 Prot.  
Tiranë, më 12, 04 2023

### Marrëveshje Bashkëpunimi

E lidhur në Tiranë midis palëve:

**Akademia e Studimeve Albanologjike**, me adresë: Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, përfaqësuar nga prof. dr. Luan Përzhita, rektor.

dhe

**DMO ALBANIA, organizatë jofitimprurëse** me adresë: Rr. "Gogo Nushi", Nd 18 Shk 5 Ap 2, Tiranë, me NIPT: L81405451F përfaqësuar nga znj Eva Kushova, drejtore ekzekutive

### **Objekti dhe Qëllimi**

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet DMO Albania dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike (Instituti i Arkeologjisë dhe Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit), për ekspertizë lidhur me përshkrimin e 5 periudhave historike të trashëgimisë kulturore të Tiranës dhe edukimin e të rinjve me trashëgiminë kulturore të Tiranës.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është koordinimi i roleve ndër-institucionale për implementimin e projektit me qëllim edukimin e brezave të rinj me trashëgiminë kulturore të Tiranës, me arkeologjinë, arkitekturën dhe etnografinë e saj.

Akademia e Studimeve Albanologjike do të caktojë specialistë përfaqësues të autorizuar prej saj për realizimin e projektit; DMO Albania do të realizojë të gjitha eventet e projektit.

### **Kohëzgjatja**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet për një afat një vjeçar. Palët me marrëveshje të shkruar, mund të shtyjnë këtë afat në varësi të ecurisë së projektit.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Palët.

### **Pikat e Kontaktit**

Pikat e kontaktit për ndjekjen e zbatimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi janë si vijon:

**Për DMO ALBANIA:** Znj. Eva Kushova, Drejtore

**Për Institutin e Arkeologjisë:** Prof. Asoc. Dr. Belisa Muka, Drejtor

**Për Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit:** Prof. Asoc. Dr. Nebi Bardhoshi, Drejtor

### **Dispozita përfundimtare**

Palët janë bashkarisht përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe përmbushjen e detyrave sipas parashikimeve të bëra në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe aplikimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përpilohet në 2 kopje.

Kushtet e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi pranohen dhe nënshkruhen nga të dyja palët.

### **Palët nënshkruese:**

**DMO ALBANIA**

Drejtore

**Eva Kushova**



**Akademia e Studimeve Albanologjike**

Rektor

**Prof. dr. Luan Përzhita**

